

FORMIMI

Neni 1

Sot me date / /1998 ne mbeshtetje te Ligjit 7638 dt. 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregtare", te Ligjit nr. 7764, date 02.11.1993 "Per investimet e huaja" dhe Ligjit 7667 dt. 28/10/1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare", ne ortaket:

1. Antonio Battaglia, shtetas italian, lindur ne Silvi, (TE) Itali, me 13.06.1953, banues ne Termoli (CB), rruga "A. De Gasperi", nr. 65;
2. Franca D'Ascanio, shtetase italiane, lindur ne Haine St. Paul (Belgjik), me 11.03.1962, banues ne Termoli (CB), rruga "A. De Gasperi", nr. 65;
3. Adriano Llali, shtetas italian, lindur ne Bonefro, (CB) Itali, me 01.02.1950, banues ne Bonefro (CB), rruga "E. Lalli", nr. 51;
4. Fatmir Satko, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 13.07.1954 dhe po aty banues ne rrugen "Azdreni", nr. 4.

me vullnetin tone te lire e te plote themelojme shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "GAMMA SHPK".

SELIA

Neni 2

Shoqeria Tregtare "GAMMA SHPK*" e ka seline ne Tirane rruga "Azdreni", nr. 4.

KOHEZGJATJA

Neni 3

Shoqeria Tregtare "GAMMA SHPK*" ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike te pakufizuar dhe mbi 10 vjet.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 4

Objekti i veprimtarise ekonomike i Shoqerise Tregtare "GAMMA SHPK*" eshte si me poshte:

- Krijimi i nje laborator per analiza kimike, klinike, hormonale, alergologjike, bakteriologjike, mikrobiologjike, infektologjike;
- Vizita mjeksore ne fushen e ekografise, seksologjise, diabetologjise, dietologjise, radiologjise, TAC, RMN, kirurgjise, gjinekologjise, endoskopise, kardiologjise, ortopedise, otorinologjise, farmacise, urologjise, psikiatrie, neurologjise, kiruugjise plastike, fizioterapise, pediatrie;
- aktivitet farmaceutik;
- organizim i kurseve te kualifikimit ne fushat mjekesore te lartepmendura.



KAPITALI I SHOQERISE

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqerise Tregtare "GAMMA SHPK*" eshte prej 100.000 leke (njqindmije leke), Ky kapital ndahet ne pjese te barabarta, vlera nominale e se ciles eshte 1000 leke, duke patur secili nga ortakët themelues kuotat e meposhtme:

ORTAKET		ne %ndaj totalit
1. Antonio Battaglia	25.000 lek	25%
2. Franca D'Ascanio	25.000 lek	25%
3. Adriano Lalli	25.000 lek	25%
4. Fatmir Satko	25.000 lek	25%
T o t a l i	100.000 lek	100 %

Te gjitha pjesët e kapitalit themeltar nenshkruhen ne teresine e tyre dhe shlyhen teresisht nga ortakët.

ORGANET DREJTUESE

Neni 6

Organet drejtuese te Shoqerise Tregtare "GAMMA SHPK*" jane Asambleja e Shoqerise dhe Administratori i saj.

Fusha e veprimit, perberja dhe funksionimi i organeve drejtuese, emerimi dhe shkarkimi i anetareve dhe ceshtje te tjera te ketyre organeve rregullohen sipas Statutit te Shoqerise, qe eshte pjese perberese e ketij Akti, si dhe me dokumente te tjera te brendshme te Shoqerise qe do te miratoje Asambleja e saj.

Neni 7

Shoqeria Tregtare "GAMMA SHPK*" ka zgjedhur si Administrator te saj Z. Fatmir Satko.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht ortakeve.

Neni 8

Shoqeria ka vulen e saj zyrtare me permbajtje: Shoqeria Tregtare "GAMMA SHPK"

BILANCI
Neni 9

Viti financiar i Shoqerise mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti.

Ne mbylljen e cdo viti financiar, Administratori i Shoqerise ben inventarin dhe llogarite vjetore, ne perputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe harton nje raport me shkrim per administrimin. Raporti i administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore te hartuara nga Administratori, i nenshtrohen miratimit te Asamblese se Ortakeve brenda nje afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 10

Ndarja e fitimit midis ortakeve te Shoqerise behet ne perputhje me kuotat e secilit ne formimin e kapitalit themeltar te Shoqerise.

PRISHJA E SHOQERISE
Neni 11

Shperberja e Shoqerise Tregtare "GAMMA SHPK*" mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredolloj shkak, sipas kriterëve te parashikuara ne nenin 16 te Statutit te Shoqerise.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME
Neni 12

Te gjitha kundërshtimet eventuale midis ortakeve te Shoqerise zgjidhem nga gjykata e rrethit te Tiranës.

Neni 13

Ky Akt themelues (kontrate) perpilohet ne 4 kopje per:

- Gjykatën e Rrethit të Tiranës, për të bërë veprimet në Regjistrin Tregtar dhe njohjen si person juridik të kësaj Shoqërie.
- Zyren e tatimeve për marrjen e lejes së ushtrimit të veprimtarisë
- Dhomen e Noterisë
- Një kopje mbetet si pjesë e dokumentacionit të themelimit të Shoqërisë Tregtare "GAMMA SHPK*".

Ortaket themelues te Shoqerise Tregtare "GAMMA SHPK"

ANTONIO BATTAGLIA

Fatmir Satko

ADRIANO LALLI

Fatmir Satko

FRANCA D'ASCANIO

Fatmir Satko

FATMIR SATKO

Fatmir Satko